



21.10.20  
12:37

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
REKTORATI**

Nr. 1689/1 Prot.

Vlorë, më, 20.10.2020

**VENDIM**

Nr. 13, datë 20. 10. 2020

**PËR**

**"SHQYRTIMI DHE MIRATIMI I PROPOZIMEVE "PËR MËNYRAT E ZHVILLIMIT TË PLANIT MËSIMOR PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021 NË KUSHTET E PANDEMISË COVID-19"**

Në mbështetje të nenit 40 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Rektorati në mbledhjen e datës 20. 10. 2020

**VENDOSI**

1. Procesi mësimor në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë për semestrin e parë të vitit akademik 2020-2021 do të zhvillohet i kombinuar (mësim online dhe në auditor).
2. Leksionet për kurset që përmbajnë numrin mbi 30 studentë do të zhvillohen online.
3. Pedagogët pa shkelur këtë vendim, të marrë në kuadër të kushteve të pandemisë, mund të bëjnë organizime të mësimdhënies për çdo klasë të tyre.
4. Njësitë kryesore dhe bazë për veprimtaritë mësimore specifike që përfshijnë (punën në laborator, praktika mësimore etj.), në përputhje me kapacitetet fizike, do të mund t'i marrin në dekanat vendimarrjet përkatëse për mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor.
5. Do të përdoret platforma GoogleMeet për zhvillimin e mësimin online. Do të mundësohet aksesimi i adresave elektronike @univlora.edu.al nga të gjithë pedagogët dhe studentët. Listat e adresave të studentëve që do të përfshihen në platformë do të jepen nga sekretariatë e departamenteve.
6. Rektori, zv.rektoret, dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve do të monitorojnë procesin e mësimin në platformën dixhitale.

**REKTORI**  
Prof. Dr. Roland ZISI

